



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS SKENDERAJ**

Numri i lëndës: 2022:241947

Datë: 29.03.2024

Numri i dokumentit: 05522438

**E.nr.0058/10**

**GJYKATA THEMELORE MITROVICË – DEGA NË SKENDERAJ, Departamenti i Përgjithshëm**, përmes gjyqtarit individual Hajrullah Aruqi me bashkëpunëtorin profesional Agron Geci, në çështjen juridike të kreditorit Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës Sh.A, tani Telekomi i Kosovës -Vala, me seli në Prishtinë, ndaj debitorit H.Z., nga fshati..., komuna Skenderaj, për borxh në shumën prej 289.34 euro, jashtë seancës gjyqësore, me datë 29.03.2024, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

**PËRFUNDOHET** procedura përbarimore e kreditorit Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës Sh.A, tani Telekomi i Kosovës -Vala, me seli në Prishtinë, ndaj debitorit H.Z., nga fshati..., komuna Skenderaj, për borxh në shumën prej 289.34 euro (dyqind e tetëdhjetë e nëntë euro e tridhjetë e katër cent) për shkak të pagesës së borxhit në tërësi nga debitori.

**A r s y e t i m**

Gjykata me Aktvendimin E.nr.0058/10 me dt.14.01.2010 e ka lejuar përbarimin sipas propozimit të kreditorit Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës Sh.A.-Vala, tani Telekomi i Kosovës -Vala, me seli në Prishtinë, ndaj debitorit H.Z., nga fshati..., komuna Skenderaj, për borxh në shumën prej 347.14 euro, ndërsa me parashtrësën e dt.26.02.2024 kreditori e bëri precizimin e borxhit, ku theksuan se borxhi aktual i debitorit është në shumën prej 289.34 euro.

Debitori e ka njoftuar gjykatën se e ka përmbushur borxhin në tërësi, kjo dëshmohet përmes dëftesave të lëshuara nga Telekomi i Kosovës nr.73270743 e dt.25.03.2024 e cila është në shumën prej 289.34 euro, si dhe taksën gjyqësore në shumën prej 15 euro me numër të pagesës 19306602-2024-Skenderaj, e lëshuar nga Posta e Kosovës dt.25.03.2024.

Gjykata duke u bazuar në nenin 66 par.4 të LPP-së, në të cilin është përcaktuar se “Pas përmbushjes së kredisë së kreditorit nxjerret vendim për përfundimin e procedurës përmbartimore”, andaj nga të lartcekurat, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA NË SKENDERAJ**  
**DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM**  
**E.nr.0058/10, me dt.29.03.2024**

**Gjyqtari**  
Hajrullah Aruqi

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa brenda afatit 7 ditor nga dita e pranimit të të njëjtit, përmes kësaj gjykate për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.